



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:227648

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05734660

**Ac.nr.8295/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. L. nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A. I. avokat në Prishtina, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK – Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi, me objekt kontestit, kompensim i të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.811/18, datë 11.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK – Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.811/18, datë 11.06.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.811/18, datë 11.06.2021, gjykata e shkallës së parë aprovuar padinë e paditëses, si dhe ka detyruar të paditurën që paditëses në emër të pagesës së diferencës së pagës nga grada 4.8 në gradën 5.4, për periudhën nga data 01.07.2016 deri më 31.10.2018, sipas vendimit nr.220/2016 të datës 01.07.2016, t’ia kompensoj në emër të pagesës bruto shumën prej 1,288.43 €, ose pagën neto në shumë prej 1,126.09 €, në emër të kontributeve pensionale që duhet të paguhen në emër të punëdhënësit në Trustin Pensional të Republikës së Kosovës shumën prej 64.42 €, kontributin pensional në Trustin Pensional të Kosovës në emër të paditëses shumën prej 64.42 €, në emër të tatimit në pagë që duhet të

paguhen në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës respektivisht ATK-së shumë prej 97.92€, të gjitha këto me kamatëvonesë 8%, e cila do të llogaritet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi datë 11.06.2021, e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë 514.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, për shkaqe të vërtetimi të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjenet se paditësja të ketë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të tij, me datën 13.03.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, të cilën e ka precizuar me datë 28.05.2021 duke kërkuar kompensimin e të ardhurave personale në shumë prej 1288.43€ në periudhën prej 01.07.2016 e deri me 31.10.2018, në emër të diferencës së pagave mujore me kamatë, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Këto paga i ka kërkuar ngase sipas vendimit të të paditurës, të njëjtës i është ndryshuar koeficienti nga 4.8 në 5.4, mirëpo të nijetin vendin asnjëherë nuk e kishte përmbushur.

Pala e paditur ka paraqitur përgjigje në padi, duke kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.811/18, të datës 11.06.2021, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësimin se nga provat e administruara gjykata ka gjetur së paditës në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratë nr. 173/2016 datë 19.02.2016. Sipas kontratës së punës në nenin 2 të saj përcaktohet se paditësi do të kryej detyrat e punës "Infermiere në QSHMSHIB-Prishtinë. Sipas nenit 6 të kontratës është përcaktuar së të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartasi prej 363.16 €, së paku njëherë në muaj, e cila nuk mund të jetë me e ultë së paga minimale. E paditura me vendimin nr. 220/2016 i datës 01.07.2016, paditëses i nivelizon koeficientin e pagës prej 4.8 në 5.4, sipas vendimit të Inspektoratit të Punës me numër protokolli nr.52/2016 dt.03.06.2016, i cili vendim hyn në fuqi nga data 01.07.2016 dhe kohëzgjatja e tij do të rregullohet me kontratë pune. Pasi që gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike gjeti se

kërkesëpapia e paditëses është e bazuar sepse e paditura me vendimin nr. 220/2016 i datës 01.07.2016, ia ka nivelizuar koficientin e pagës, ndërsa që nuk e ka zbatuar vendimin të cilin e ka marrë vet, në rastin konkret e paditura ka përcaktuar se të punësuarit-paditëses i caktohet koeficienti i pagës prej 4.8 në 5.4. për të vërtetuar lartësinë e kompensimeve, ka arsyetuar se nga administrimi i ekspertizës financiare në cilësinë e provës materiale gjykata ka gjetur se sikur paditësja të realizonte pagat me diferencën në mes koficientit 4.8 në 5.4 për tërë periudhën 01.07.2016 deri më 31.10.2018 do të realizonte të ardhura personale në shumë edhe atë: që në emër të pagesës bruto shumë prej 1,288.43 €, neto paga e diferencës që duhet paguar punëtores është në shumë prej 1,126.09 €, kontributin pensional në Trustin Pensional të Kosovës në emër të paditëses shumë prej 64.42 €, kontributin pensional në Trustin Pensional të Kosovës në emër të punëdhënësit shuma prej 64.42 € dhe tatimin në pagë në Administratën Tatimore të Kosovës në shumë prej 97.92 €. Më tej ka arsyetuar se sipas dispozitave ligjore një ndër të drejtat themelore të punëtorit është paga, në këtë rast e drejtë themelore e paditëses është paga të ardhurat personale, sipas dispozitave nga neni 55 i Ligjit të Punës, të cilën të drejtë paditësja nuk e ka realizuar..

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Nuk kishte pretendim ankimor specifik për sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, prandaj gjykata kufizohet në vetëm ato që kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit, e ka pranuar në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë referuar gjendjen faktike të vërtetuar më pas duke e kualifikuar në përputhje me normat materiale, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka qenë rrethanë kontestuese fakti së paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në pozitën infermiere, sipas kontratës së punës. po ashtu nuk është kontestuar se e njëjta sipas një marrëveshje të mirëkuptimit të datës 20.10.2015, është transferuar në vendin e punës në Prishtinë. Gjykata e shkallës së arë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike që i përket provave kishin të bënin me bazën që garantonte kompensimin paditëses, që ishte vendimi i të paditurës i datës 01.07.2016, përmes së cilës paditës i ndryshohej koeficienti, ashtu që nga 4.8 kalohej në 5.4. Për të vërtetuar ndryshimin në të ardhura personale, pra dallimi ndërmjet koeficienteve tashmë të ngritur, gjykata përmes ekspertizës financiare kishte vërtetuar se neto paga e diferencës që duhet paguar punëtores është në shumë prej 1,126.09€, kontributin pensional në Trustin Pensional të Kosovës në emër të paditëses shumë prej 64.42€, kontributin pensional në Trustin Pensional të Kosovës në emër të punëdhënësit shuma prej 64.42€ dhe tatimin në pagë në Administratën Tatimore të Kosovës në shumë prej 97.92€. Nga analizimi i thënieve në ankesë, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keq interpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një prove e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Si rrjedhojë e vërtetimit të gjendjes faktike dhe peshimit të duhur të fakteve dhe provave, gjykata ka arritur që gjendjen faktike të kualifikoj drejtë në normat materiale të Ligjit e Punës Nr.03/L-212.

Gjykata Apelit vlerëson se bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se e paditura detyrohet të bëjë kompensimet e diferencës së pagave, si ndryshim ndërmjet koeficientëve 4.8 në 5.4. Ligji i Punës, në nenin 55 par. 1 dhe 2 rregullon “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit. 2. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.” E paditura me akt të brendshëm të nxjerrë, ka marrë vendim duke i ngritur gradën paditëses, kurse pasojat juridike të atij vendimi nuk i kishte përmbushur, ngase ngritja e gradës ka nënkuptuar edhe ngritjen e pagës. Periudha për të cilën mbi të paditurën bie detyrimi, përfaqëson kohën nga data e marrjes së vendimit 01.07.2016 deri në kohën kur e paditura i kishte rregulluar kompensimin sipas gradës ngritur me vendim, që është data 31.10.2018.

Në këtë rast është kontestues, e paditura me vullnet të njëanshëm e ka nxjerr vendimin mbi caktimin e lartësisë së të ardhurave personale duke i ka caktuar të ardhurat mujore në lartësi të gradës 5.4, kurse në anë tjetër të njëjtin vendim nuk e kishte zbatuar. Gjykata vlerëson se pagesa e shumës së lartcekur paditëses është adekuate dhe e drejtë.

Mënyra e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë për sa i përket kamatës, nuk është ndryshuar, ngase nuk kishte ankesë nga pala paditëse. Ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, porse nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.8295/2021, datë 23.05.2024**

**Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**